

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Fejzullah Rexhepi dhe Qerim Ademaj, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses L.K. e lindur Sh. nga fshati ...- Republika e Shqipërisë, kundër të paditurit V.K. nga fshati ... Komuna e Malishevës, për shkak të zgjidhjes së martesës me shkurorëzim, duke vendosur sipas ankesës të paditurit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, C.nr.199/2015 i datës 23.09.2016, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 24.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurit V.K. nga fshati ... Komuna e Malishevës dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, C.nr.199/2015 i datës 23.09.2016 në pikën I të dispozitivit,

II.PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, C.nr.199/205 të datës 23.09.2016 në pikën II të dispozitivit dhe lënda në këtë pjesë i kthehet Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë , në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit është zgjidhë martesa me shkurorëzim në mes të paditëses dhe të paditurit, martesë e lidhur me datë 30.12.2011, pa Zyrës së Gjendjes Civile në Malishevë, ..., nën numrin rendor ... dhe nr. të referencës ... Në pikën II të dispozitivit lidhur me padinë e paditëses për besimin e fëmijëve të mitur, alimentacionit dhe gjësëndeve personale është vendosur që procedura do të zhvillohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit mbi zgjidhjen e martesës.

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri në afatin ligjor ka ushtruar ankesë pa cekur bazat ligjore të atakimit të aktgjykimit duke theksuar se vajza e mitur ... ka lindur me datë 10.02.2013 në fshatin ... Komuna e Malishevës, duke theksuar se këto thënie i dëshmon me certifikatën e lindjes e cila i është bashkëngjitur ankesës, e cila gjë ia pamundëson vizitën e fëmijut.

Përgjigje në ankesa nuk ka pasur.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja L.K. e lindur Sh. nga fshati ...- Republika e Shqipërisë, ka ushtruar padi kundër të paditurit V.K. nga fshati ... Komuna e Malishevës për shkak të zgjidhjes së martesës, besimin e fëmiut, alimentacion dhe kthimin e gjësendeve personale, me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadisë si dhe kërkesëpadinë e precizuar në shqyrtimin e datës 23.09.2016 si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata në procedurën e provave ka bërë nxjerrjen e provave përmes leximit të certifikatës së martesës të datës 06.07.2015 e lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Malishevë-..., si dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda PKR.nr.115/2014 i datës 22.06.2015. Nuk ishte kontestues në mes të palëve fakti se paditësja me të paditurin kanë lidhur martesë me datë 31.12.2011 pan zyrës së gjendjes civile në Malishevë-..., ndërsa me aktgjykimin e cekur më lartë i padituri është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.5 të KPRK si dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 i ligjit të cekur dhe për këtë është gjykuar me dënim unik në kohëzgjatje prej 16 vite e 16 muaj, dhe pas vlerësimit të këtyre provave nga ana e gjykatës si dhe dispozitave të nënti 69 par.1 dhe 2 të LFK-së dhe dispozitave të nenit 147 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, me arsyetim se i padituri në seancën përgatitore ka deklaruar se e ka pranuar zgjidhjen e martesës, me kusht që fëmiu i mitur ti besohet në ruajtje, edukim dhe ushqimi, e gjykata duke pasur parasysh dispozitat ligjore të cekura më lartë dhe provat shkresore të cekur ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore për zgjidhjen e martesës bazuar në dispozitivin e nenit 69 të LFK-së, me arsyetim se raportet martesore në mes të paditëses dhe të paditurit janë çrregulluar seriozisht për shkak të jetës së padurueshme, por edhe për faktin se i padituri e ka kryer veprën penale të vrasjes të vëllait të paditëses në oborrin e shtëpisë së tij, si dhe faktin se bashkëshortët që nga data 09.02.2014 jetojnë ndaras. Ndërsa sa i përket besimit të fëmiut të mitur gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë procedurë gjyqësore nuk ka vendosur me arsyetim se kjo pjesë e kërkesëpadisë nuk është pjekur për gjykim, për deri sa, sa i përket besimit të fëmiut duhet ti dërgohet kërkesa Qendrës për Punë Sociale në Shqipëri përmes Ministrisë së Drejtësisë.

Kjo gjykatë, duke e vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket pikës I të dispozitivit të aktgjykimin të atakuar, ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar, se ka mbështetje në dispozita ligjore si dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsye të justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195 par.1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

Në mbështetje të dispozitave të nenit 195 par.1 nën c) të LPK-së kjo gjykatë vendosi si në nën pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e prishi aktgjykimin e atakuar në pikën II pasi që në këtë pjesë aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 lidhur me nenin 2.3 të LPK-së, e kjo konsiston në faktin se në dispozitën e nenit 2.3, parashihet, "Gjykata nuk mund të refuzoj shqyrtimin për vendosjen mbi kërkesat që janë në kompetencën e saj", e duke komentuar në këtë dispozitë ligjore dhe kërkesëpadinë e paditëses e cila nuk ka të bëjë vetëm me zgjidhjen e martesës, por është pjesë e kërkesës të padisë edhe besimi i fëmiut, alimentacioni dhe kthimi i gjësendeve personale të paditëses, nga kjo rrjedhë se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar kësaj dispozite ligjore, e kur dihet se kjo dispozitë ligjore për një gjë të tillë e obligon gjykatën që të vendos për të gjitha kërkesat e jo siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, "se rreth besimit të fëmiut të mitur, alimentacioni dhe gjësendeve personale procedura do të zhvillohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimin të atakuar mbi zgjidhjen e martesës, andaj gjykata e shkallës së parë për pjesën e prishur është e detyruar që në riprocedurë duhet të vendos meritorisht lidhur me kërkesëpadinë e paditëses rreth alimentacionit dhe besimit të fëmiut, pasi që kërkesa të tilla në bazë të LFK-së trajtohen si kërkesa të natyrës së shpejtë, pasi që është në pyetje fëmiu i mitur, kurse sa i përket gjësendeve personale në kuptim të dispozitave të nenit 89 të LFK-së, një kërkesë e tillë mund të zgjidhet edhe pas mbarimit të shkurorëzimit, ashtu që pas evitimit të metave të sipërpërmendura, vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, fakteve dhe rrethanave të sipërpërmendura, vlerësimit të drejtë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe mendimi i Qendrës për Punë Sociale në Malishevë, po ashtu gjykata në rrugë diplomatike të kërkoj nga organet kompetente të Republikës së Shqipërisë mendimin lidhur me besimin e fëmiut në ruajtje, mbajtje dhe edukim e pastaj të merr vendim të drejtë, meritor dhe të bazuar në ligj.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.4735/2016 më dt. 24.01.2017

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni,

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt. 24.01.2017, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

V ë r t e t o j n ë:

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. _____

2. _____